



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e dymbëdhjetë - XII e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 30.11.2023, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Ali Ismaili - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Bashkim Krasniqi - Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete, Mirlinda Krasniqi, Miranda Shabani, Jetmir Berisha, Vjollca Konjusha, Krenar Dumani, Laureat Gojnovci, Jahush Krasniqi, Fisnik Sllamniku, Etnik Berjani, Durim Hajra, Hasime Kostanica, Doruntina Jashari, Shpend Bardiqi, Habib Mekolli, Vlonjat Hasani, Mirsad Qyqalla, Dardane Sogojeva Shala, Aida Alimi, Migjen Kolshi, Qëndresa Ademi, Artan Asllani, Arbnore Kelmendi, Hasan Ismajli dhe Radoman Doderovic.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Besnik Osmani - Nënkryetar i Komunës, Ekrem Berjani - Drejtor për Zhvillim Ekonomik, Ilir Hasani - Drejtor për Gjeodezi Pronë dhe Kadastër, Ali Topalli - Drejtor për Kulturë Rini dhe Sport.

Të tjerë: Lindita Dervisholli / Prebreza - Njësi për Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjimore.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës e datës 28.09.2023 dhe 31.10.2023.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores për taksa komunale për subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
4. Propozim për shfuqizimin e vendimit Nr. 86, të datës 06.04.2023.
5. Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores për orarin e punës së subjekteve afariste që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
6. Propozim për shfuqizimin e vendimit Nr. 87, të datës 06.04.2023.
7. Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores për Transportin Rrugor në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
8. Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve.
9. Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
10. Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores për Transparencë.
11. Shqyrtimi i parë i Planit të Veprimit për Transparencë për vitet 2024-2027.
12. Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores për Standardet minimale të pjesëmarrjes në diskutime publike.

13. Propozim për shqyrtimin e vazhdimin të taksave administrative për lëshimin e lejeve ndërtimore dhe tarifave për rregullimin e infrastrukturës për vitin 2024 në Komunën e Fushë-Kosovës.
14. Propozim për formimin e Komisionit për zgjedhjen e krijuesit dhe sportistëve për vitin 2023.
15. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndeti të pranishmit në mbledhje. Lexoi pikat e rendit të ditës për shqyrtim në mbledhjen e sotme dhe informoi anëtarët e Kuvendit të Komunës, për pikën e parashtruar për shqyrtim në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga Grupi Parlamentarë i Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me faljen e një qind eurove të tatimit në pronë për vitin 2023

Remzi Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ju falënderoi të gjithëve juve kolegëve, Kryesuesin e Kuvendit të Komunës, Nënkryetarin e Komunës, ju informoi juve se javën e kaluar unë kam dhënë dorëheqje dhe nuk do të jem më anëtar i Kuvendit të Komunës, unë jam në mandatin e tretë në Kuvendin e Komunës, kam qenë anëtar i Kuvendit të Komunës për dhjetë vite, për mua kjo është dita më e vështirë për mua, unë mendoj se e kam kryerë punën time si duhet, në funksion të krijimit të kushteve më të mira për qytetarë, nuk do ta zgjati shumë, ju falënderoi të gjithëve për bashkëpunimin, kolegët nga partia ime për përkrahjen dhe juve kolegëve të opozitës, po ashtu edhe përfaqësuesit e Ekzekutivit të Komunës, tani unë besoj se kontributin tim profesional do ta jap në fushën e shëndetësisë, duke u munduar që ta japim shërbime më të mira shëndetësore dhe kualitative, për qytetarët e komunës tonë.

Hasan Ismajli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë nga tani do të jem pjesë e opozitës, andaj për këtë punë dua të ju njoftoj juve i nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës, anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe Nënkryetarin e Komunës. Marrëveshja e Bashkëpunimit me Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, është shkëputur njëanshëm, për këtë punë është njoftuar lideri ynë z. Ramush Haradinaj, ndërsa konstatimi i thënë aty nuk është burrënorë, aty është thënë se unë nuk jam konstruktiv dhe po ndikoi në prishjen e punës, në vazhdim lexoi një pjesë të asaj letre të Kryetarit të Komunës, dërguar Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, unë këtë e lexova për të vetëdijësuar anëtarët e Kuvendit të Komunës, sepse ne jemi këtu si përfaqësues me votat e qytetarëve, për të ndryshuar diçka, por konstatimi i Kryetarit të Komunës aty është, se unë po e prishi harmoninë e Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, është jo korrekt dhe i pavërtetë.

Durim Hajra: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne i dëshirojmë suksese doktor Remit në fushën e tij, si profesionistë në shëndetësi, këtu në Kuvendin e Komunës kemi patur mospajtime në shumë çështje, meqë ai ka përfaqësuar qëndrimet e tij, si Shef i Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Tani unë dua ta paraqes propozimin tonë për faljen e një qind eurove të tatimit në pronë për vitin 2023, pas marrjes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese, këtë propozim ne e kemi paraqitur edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa, kërkesa jonë është në interesin e qytetarëve, nuk është përkrahur nga shumica parlamentare në atë mbledhje, kërkesa jonë është dashur të shpërndahet këtu për shqyrtim, prej juve i nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës të mos përdorni standarde të dyfishta, sepse ky standard i pikave shtesë në momentin e fundit është shndërruar në praktikë të punës tonë, e ripërsërisim kërkesën tonë që kjo pikë të shqyrtohet në mbledhjen e sotme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ajo që u cekë nga Shefi i Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, është pjesërisht e vërtetë, edhe pika e Drejtorisë së Planifikimit Urban nuk ka kaluar në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, pika e juaj ka ardhur në emalin tim dhe të Kryetarit të Komunës, andaj e kam lajmëruar për shqyrtim në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, ju këtu po e keqpërdorni mirësinë time, unë edhe propozimin e juaj do ta hedh në votim si pikë shtesë.

Laureat Gojnovci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani unë këtu e theksoi se kolegut tonë doktor Remzi Shala, i dëshirojmë shëndet dhe suksese në punë, kemi emocione, sepse ai e ka përfaqësuar partinë tonë dhjetë vite në Kuvendin e Komunës, ndërsa për gjashtë vite e ka udhëhequr Grupin Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ne këtu nuk duam të bëhemi pjesë e votimit për larjen e mëkateve të dikujt, që janë Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ku me propozimin e saj është marrë vendimi i Qeverisë së Kosovës, vendimi është dërguar në Gjykatën Kushtetuese, ku niveli qendror e ka bartur barrën tek komunat, për faljen e tatimit në pronë, si përgjigje në vlerësimin e faturave të vitit 2022, ku kërkohet të mirren masa, e barra të bartet te qytetarët e komunës tonë, në nenin 4, paragrafi 11.2, tatimi në pronë për vitin 2023, bëhet në bazë të rivlerësimit të vitit 2022, ky vendim mbetet në fuqi, çfarë ndodh këtu me tatimin në pronë, rrezikohen të hyrat e komunave, projektet kapitale të planifikuara për realizim në vitin 2023, ne nuk mund të bëjmë asnjë dalje të tatimit në pronë, pa një analizë të mirëfilltë të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit, pastaj ne do të veprojmë si Kuvend i Komunës, mbështetur në faktet që na jepen nga këto Drejtori Komunale.

Mirsad Qyqalla: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Këtu për të hequr rrjedhën e dobët të argumenteve, pa u lëshuar në histori shumë, ne të gjithë e dijmë si ka rrjedhur kjo punë dhe procesi në kuadër të Gjykatës Kushtetuese, ne tani jemi vendosur para një nevojë urgjente, këtë punë e kemi trajtuar edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, kemi kërkuar që për çështjet që vijnë si pika shtesë ta kemi një qëndrim unik. Ne e dijmë që në këtë Kuvend të Komunës është marrë vendim për faljen e tetë qind mijë eurove për bizneset e komunës. Ne kemi qëndrim të njëjtë me secilin grup parlamentarë, kur bëhet fjalë për interesin e qytetarëve, të njëjtin qëndrim do ta kemi edhe nëse ky propozim vjen në shqyrtim nga Grupi Parlamentar i shumicës në Kuvendin e Komunës, pra Lidhjes Demokratike të Komunës, tani me vendimin e Gjykatës Kushtetuese dëmtohen komunat në aspektin financiar, secili e ka arsyetimin logjikë, se rrezikohen projektet e planifikuara publike. Ne nuk mund të veprojmë sipas veprimeve të Grupeve tjera parlamentare, këtu ne do të abstenojmë, të njëjtin qëndrim do ta mbajmë në secilin rast lidhur me këtë çështje.

Hasan Ismajli: Unë këtu do ta mbajë qëndrimin politikë që e kemi ne si subjekt politikë në nivel të vendit, por mua më nxiti për diskutim anëtari i Kuvendit të Komunës z. Laureat Gojnovci, unë nuk dua të jem kundër kur fiton qytetari, ne nuk e dijmë as koeficientin për vitet e tjera për banim, unë kërkoi që ta ruajmë gjuhën e komunikimit, sepse mëkate ka në secilën anë, madje në komunën tonë ka shumë probleme, për të mos hyrë me emra familjarë, apo fletë poseduese të njerëzve të caktuar, për shumë punë në nivelin lokal te ne, sepse veprimet e partive politike janë tjera dhe për interesin e tyre politikë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese mbështeten në fakte dhe prova që burojnë nga legjislacioni në fuqi.

Durim Hajra: Thëniet e kolegut tim z. Laureat Gojnovci janë kontradiktore në vetë vete dhe aspak ligjore, përmirësimi është bërë nga Gjykata Kushtetuese, ajo në opinionin e vetë ligjor i ka dhënë të drejtë Qeverisë së Kosovës. Ruajtjen e buxhetit e dëmton edhe falja e borxheve për bizneset,

buxheti i komunës, duhet të ruhet që të mos ketë keqpërdorim, e dyta lidhur me çështjen e pikave urgjente për shqyrtim, kjo pikë e plotëson këtë kusht, sepse e ka një afat ligjor brenda të cilit duhet të marrim një vendim, po ashtu këtu te ne, ku standard është ndryshuar disa herë, janë shqyrtuar me dhjetëra propozime si pika shtesë.

Shpend Bardiqi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani për t'iu ndërlidhur me diskutimin e Shefit të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, as uji nuk i lanë mëkatet e juaja, këtu për dy vite komuna i ka bartur mbi dhjetë milion euro, meqë nuk dinë të shpenzojnë dhe realizojnë projekte të mira kapitale në interesin e qytetarëve, këto para po zhvlerësohen edhe nga inflacioni. Ju këtu jeni falë votës së qytetarëve, të cilëve nuk jeni në gjendje t'iu falni tatimin në pronë për një vitë buxhetor, edhe pse e keni mundësinë pas opinionit të Gjykatës Kushtetuese, e në anën tjetër thirrëni se jeni parti institucionale, por mua më vjen keq për qytetarët e komunës tonë, meqë pushteti aktual është katandisur në këtë gjendje dhe vepron politikisht, pa përfillur rregullat e shkruara dhe pa zbatuar argumentet.

Mirsad Qyqalla: Këtu dua të reagoi në diskutimin e anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Durim Hajra, unë në diskutimin tim e theksova se nuk pajtohem me këtë mënyrë të trajtimit të organit më të lartë të komunës, në rastin konkret ne do të abstenojmë, qoftë kur kjo pikë propozohet nga ju apo nga pushtetit. Lidhur me këtë punë duhet ta kemi një propozim me analizë për faljen e tatimit në pronë, sepse ka patur paqartësi dhe fajësime të dyanshme nga pushteti qendror drejtë pushtetit lokal dhe anasjelltas.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për hyrje në rendin e ditës 'Kërkesën e Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje për faljen e një qind eurove të tatimit në pronë për faturat tatimore të vitit 2023'.

U votua me: gjashtë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe katër abstenime, gjithsej dhjetë anëtarë të Kuvendit të Komunës pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se 'Kërkesa e Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje për faljen e një qind eurove të tatimit në pronë për faturat tatimore të vitit 2023', në mungesë të votave nuk kalon për shqyrtim në rendin e ditës.

Në vazhdim anëtarët e Kuvendit të Komunës nga Grupi Parlamentarë i Lëvizjes Vetëvendosje e lëshuan mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim rendin e ditës për shqyrtim në mbledhjen e sotme të Kuvendit të Komunës.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej gjashtëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje e aprovoi rendin e ditës.

Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të datës 28.09.2023 dhe 31.10.2023.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani i kemi për shqyrtim dhe aprovim dy ekstrakte të procesverbaleve, nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura me datën: 28.09.2023 dhe 31.10.2023, hap diskutimin për vërejtjet dhe sugjerimet e juaja.

Mirsad Qyqalla: Ne nuk do të votojmë për ekstraktet e procesverbaleve, për deri sa nuk respektohen dispozitat e 'Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës'.

Hasan Ismajli: Unë i kam disa vërejtje për përmirësime në faqën njëmbëdhjetë, njëzet dhe njëzet e një, në diskutimin tim kam thënë, se është investuar pak dhe se çerdhja është te kompleksi 'Eliza C', kam thënë se aty është një objekt prej 400 metra katrorë, i cili do të jetë çerdhe, unë në foltore kam thënë se auditori i jashtëm ka qenë i njëanshëm kur e ka evidentuar shtrurjen e kubëzave të betonit në pronën private, por jo edhe asfaltimin e rrugëve në shumë prona private, ndërsa për fushën e arsimit ju i keni patur njëzet e katër norma të reja në arsim për vitin paraprakë, është marre në çfarë gjendje e keni lënë arsimin.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, i qiti në votim për aprovim, ekstektet e procesverbalit nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura me datën: 28.09.2023 dhe 31.10.2023, me vërejtjen e cekur nga anëtari i Kuvendit të Komunës z. Hasan Ismajli.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me uanaimitet të votave të anëtarëve të pranishëm të Kuvendit të Komunës në mbledhje i aprovuan: ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura me datën: 28.09.2023 dhe 31.10.2023, me vërejtjen e cekur nga anëtari i Kuvendit të Komunës z. Hasan Ismajli.

Pika e dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës, që të parashtrijnë ndonjë pyetje, nëse kanë për Ekzekutivin e Komunës.

Dardane Sogojeva Shala: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Tani e kam një pyetje për Drejtoreshën e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, rentgeni në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, është jashtë funksionit, andaj kërkoi të zhvillohet një procedurë e shkurtër dhe të blihet kaseta për funksionalizimin e tij, sepse pacientët tanë nuk po kanë mundësi të marrin shërbime shëndetësore. Për Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, me datën 27 nëntor ka qenë shumë akull në oborrin e shkollës 'Mihal Grameno' në Fushë-Kosovë, ku fëmijët janë lënduar gjatë shkuarjes në shkollë, në oborrin e shkollës, sepse rruga ka qenë në gjendje të tmerrshme, apo kjo punë duhet të ndryshohet, mund të rregullohet ndoshta, edhe nga Drejtori i Drejtorisë së Infrastrukturës, të vendosen kamionët në rrugë për pastrimin e rrugëve, atë ditë në rrugë kanë qenë vetëm dy kamiona, ne kërkojmë sqarime për këtë situatë të krijuar, pse nuk është vepruar me kohë, po ashtu ka patur edhe mungesë të furnizimit me ujë 24 orë, në disa zona të qytetit tonë. Po ashtu kërkojmë që Drejtoria e Arsimit, të marrë masa për trajtimin e nxënësve me sëmundje të rënda, këta nxënës të barten në Qendrën trajtuese në komunat e tjera, unë e kam fjalën për një fëmijë me autizëm nga fshati Bardh i Madh, i cili është në klasën e nëntë, duhet të gjejmë një zgjidhje për këtë çështje, për trajtimin më serioz të fëmijëve me aftësi të kufizuara, t'i ndihmojmë prindërit e tyre, sepse kanë halle të mëdha, edhe në aspektin shëndetësorë, kanë shpenzime të mëdha, andaj duhet të përkrahen.

Hasan Ismajli: Unë tani këtu i kërkoi dy sqarime për shpenzime të buxhetit në kodin e Kuvendit të Komunës, fjala është për asistenten tuaj, i nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës, e cila e ka marrë një shumë të mjeteve financiare shtesë në kategorinë e pagave, unë ju pyes juve çka punon ajo për Kuvendin e Komunës, kur ne e dijmë se të gjitha punët kryhen nga Zyrtari i Kuvendit dhe dy punëtorë të Projektit të Karitasit, andaj unë kërkoi sqarime nga ju për punët e kryera nga

asistentja e juaj. Ndërsa Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete, në dy muajt e fundit i ka realizuar dy udhëtime në Zvicër me paratë e Kuvendit të Komunës, nga kategoria e mallërave dhe shërbimeve, ne i kërkojmë agjenden e takimeve të tij, nuk jemi që kjo të kalojë kështu në mënyrë të papërgjegjshme, pa asnjë sqarim për vizitën në fjalë, nuk pajtohemi me konstatimin e juaj se letrat janë të gjitha në Drejtorinë e Financave dhe Buxhetit, ne kërkojmë llogari për shpenzimet e tij. Ne kërkojmë nga Drejtoria e Inspektoratit, që të intervenoni në fund të rrugës ‘Tahir Zemaj’, ku ka shumë kablo dhe rrethoja në skaje të rrugës, kjo është papërgjegjësi e tyre, pra e ndërtuesve, por edhe e Korporatës për shpërndarjen e rrymës, këto janë të gjetura edhe nga krimet ekonomike dhe ata do të mirren me të, por aty ka rrezik për fëmijët që kalojnë andej, kur shkojnë në shkollë.

Fisnik Sllamniku: Tani lidhur me punëtorët teknik të shkollave, që u cekë nga anëtarja e Kuvendit të Komunës znj. Dardane Sogojeva Shala, është përgjegjësi e komunës heqja e borës nga rruga, atë ditë ka patur rreshje të borës, ka qenë ditë e vështirë, por shumë shpejtë janë marrë masa nga institucionet shkollore, punëtorët teknik kanë përgjigjësi brenda shkollës, nuk janë për heqjen e borës. Ne duhet të kemi kujdes edhe për monitorim e fenomenin e braktisjes së shkollës, sepse ka raste në shkollat e qytetit, ne e dijmë se funksionon një ekip veprues për monitorimin e kësaj çështje, normal që pas punës në këtë drejtim tani braktisja e shkollës në numër, nuk është sikur para pesë apo dhjetë viteve, por secili rast duhet të trajtohet.

Zyrtarja për Barazi Gjinore: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në vizitën zyrtare në Bashkinë e Tiranës kanë qenë gratë profesioniste të sektorëve të ndryshëm të komunës, ju secilën herë keni qenë pjesë e projekteve të mia, por nuk keni marrë pjesë disa herë, këtu nuk ka asgjë politike, por edhe ju në muajin mars keni qenë në vizitë për përgatitjen e Planit të Punës, pa përfaqësuese të sektorëve të Administratës Komunale dhe nuk e keni mbajtur asnjë takim në vijim, për përfundimin e këtij plani, unë nuk dua të lëshohem këtu në nivel të ulët të diskutimit; sepse e respektoi secilën dhe jam e hapur për bashkëpunim, ju në atë vizitë keni qenë vetëm pesë gra, nga Kuvendi i Komunës dhe askush nga Administrata e Komunës.

Aida Alimi: Ne këtu bëjmë shumë pyetje dhe nuk marrim përgjigjëje, njësoi është edhe me parafolësen e cila i bënë komentet e veta dhe largohet nga Salla e Kuvendit të Komunës, duke i ikur ballafaqimit direkt, unë kërkoi që së paku të jetë dikush nga anëtarët e Kuvendit të Komunës e jo unë, ne kemi mundur të përfaqësohemi nga znj. Vjollca Konjusha, janë të pavërteta informatat se jemi ftuar në aktivitete që janë organizuar në shkollë gjatë vitit 2021, sepse aktivitetet e saj janë puro-politike dhe jo gjithëpërfshirëse, bile na është thënë se ardhja me ne e përfaqësuesve të subjekteve tjera politike, po na e prish atmosferën. Tani unë e kam një kërkesë lidhur me çështjen e sigurisë, ku ka ndodhur një kidnapim i fëmijëve, njoftimi ka qenë përmes portaleve të Kosovës, ne kërkojmë që të mirren masa në fushën e sigurisë, andaj ne kërkojmë që të kemi një raportim nga Policia e Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë nuk dua ta luaj rolin e avokatit në aktivitetet e fushatës kundër dhunës në familje, por nuk lejoi herave të tjera që dikush të thotë fjalët e saj, ashtu sikur u thanë dhe të ikë nga mbledhja, pa u ballafaquar me kundër argumentet e palës tjetër. Unë në fillim të mandatit tonë, pra në marsin e vitit të kaluar e kemi përkrahur me buxhetin e Kuvendit të Komunës, aktivitetin për javën e gruas, ndërsa këtë vit me vendimin e Kryetarit të Komunës është përkrahur vizita e Grupit të Grave në Shqipëri, unë kërkoi që të respektohet Kryesuesja e Grupit

të Grave, që në rastin tonë është anëtare e Kuvendit të Komunës, e jo të veprohet në këtë mënyrë me pa përgjegjësi, e sidomos këtu në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Mirsad Qyqalla: Nuk duhet të lejohet një qasje e tillë në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, pavarësisht se kush tenton ta bënë këtë, ju po e shihni në shumë mbledhje mos prezencën e përfaqësuesve të Ekzekutivit të Komunës në mbledhje të Kuvendit të Komunës, në shumë raste ne nuk kemi kujt t'i drejtohem, qoftë me ndonjë pyetje, qoftë për sqarime konkrete për propozimin e caktuar, kjo qasje duhet të ndërrohet, duke filluar edhe nga ne vetë, të mos lejojmë një qasje të tillë, duke pranuar pika shtesë në momentin e fundit, pa ndonjë urgjencë, por vetëm me kërkesa të Ekzekutivit të Komunës. Kujt duhet t'i drejtohem ne tani për problemet me pastrimin e borës nga komuna, ideja këtu është se rruga për Lismir, ka qenë me borë dhe ka patur vështirësi, e pa pastruar më vonë ka patur postime në rrjetet sociale, se nga rrugët lokale bora po largohet, ne kërkojmë llogari dhe punë nga Nënkryetari i Komunës dhe Drejtori për Infrastrukturë, të kontraktohet një Kompani dhe këto punë të kryhen, ju e dini se rruga Lismir/Bardh i Madh përdoret shumë nga banorët e disa fshatrave tona, kryerja e këtyre punëve nuk është çështje e lluksit, qytetarët dëshirojnë t'i marrin shërbimet, e jo t'iu thuhet nuk kemi kontratë valide tani, sepse kompanitë janë të pa përgjegjshme, kjo nuk duhet të bëhet një përgjigje e zakonshme për ne, këtu ne i paraqesim kërkesat që na vijnë nga qytetarët e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Po asistentja që është në kuadër të listës së pagave të Kuvendit të Komunës, i ka marrë 400.00€, kompenzim për punë shtesë, ajo punon për Ekzekutivin e Komunës, në Drejtorinë e Arsimit unë nuk i kam dhënë asnjë detyrë asaj, unë nuk e diç nga kush është angazhuar ajo për punë shtesë, ndërsa lidhur me Zëvendës Kryesuesin e Kuvendit të Komunës për Komunitete, unë e kam marrë një raport për vizitën para dy ditëve dhe atë do t'iu jepi Shefave të Grupeve Parlamentare dhe subjekteve politike.

Hasan Ismajli: Një zyrtar komunal punon në komunë nga ora 8-16h, për secilën orë shtesë jashtë këtyre orëve, duhet të dokumentohet për të realizuar pagesa, kur Administrata Komunale ka nevojë për punë shtesë, kjo punë verifikohet me procesverbalin e punës së kryerë, ndërsa lidhur me Zëvendës Kryesuesin e Kuvendit të Komunës për Komunitete z. Bashkim Krasniqi, ka shkuar atje me ftesë partiake, unë mund të marrë ftesë nga degët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës jashtë vendit dhe do të kërkoj mbështetje nga buxheti i komunës, sepse ai atje është paraqitur si përfaqësues i Kuvendit të Komunës.

Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete: Unë kam qenë në vizitë zyrtare, për udhëtimin tim zyrtar raportin e kam dorëzuar në Drejtorinë e Financave dhe Buxhetit, me këtë raport unë e informoi Kryesuesin e Kuvendit të Komunës dhe Kryetarin e Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: U cek nga vetë Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete, e tha qëndrimin e tij e dorëzon raportin, shpenzimet janë bërë nga buxheti i Kuvendit të Komunës.

Pika e tretë (3) - Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores për taksa komunale për subjektet afariste që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Diskutimin për shtatë rregullore komunale dhe një plan të veprimit, mund t'i bashkojmë nëse kemi një dakordim, sepse shumica nga ne kemi qenë pjesëmarrës në kuadër të Grupeve Punuese dhe vetë e dijmë substancën e përgatitjes së këtyre

rregulloreve, kuptohet me pjesëmarrje ndoshta edhe minimale në ndonjërin nga Grupet Punuese, por dikush nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, së paku ka qenë në njërin grup të punës shumicën e kohës, ndërsa në fund vendimet i marrim një nga një.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës u pajtuan që diskutimi për Projekt-Rregullore dhe Planin e Veprimit të bëhet i bashkuar, ndërsa vendimet në fund të mirren një nga një, duke patur parasysh edhe shfuqizimin e vendimit Nr. 86, të datës 06.04.2023, për aprovimin në parim për diskutim publikë të 'Projekt-Rregullores për orarin e punës së subjekteve afariste që ushtrojnë veprimtari ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës' dhe vendimit Nr. 87, të datës 06.04.2023, për aprovimin në parim për diskutim publikë të 'Projekt-Rregullores për Transportin Rrugor në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.

Laureat Gojnovci: Unë tani do të flas më shumë për rregulloren e taksave komunale, ku kemi punuar bashkarisht me zyrtarët e komunës nga Drejtoritë përkatëse, ku janë analizuar taksat komunale në disa fusha, me debate konstruktive dhe analizim të çështjeve, në këtë grup punues bashkëkryesues kanë qenë z. Besim Tërmkolli dhe z. Ekrem Gojnovci. Kjo projekt-rregullore i ka pesëmbëdhjetë kapituj dhe 68 nene, të cilat e ndërtojnë gjendjen aktuale të bizneseve, vendosin taksa komunale vjetore për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike, por edhe taksa komunale për shërbime administrative, ne po ashtu kërkojmë të krijojmë një ambient të mirë për zhvillimin e mëtejshëm të biznesit, bëjmë dallimin e bizneseve të cilat kanë njësi në komunën tonë, po ashtu kemi propozuar që të lirohen bizneset fillestare që regjistrohen nga gratë, ndërsa tek 'Rregullorja për orarin e punës së subjekteve afariste që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës', kemi bërë ndarjen e orarit për sezonin dimëror dhe verorë të punës, me përshkrim për fushën përkatëse, mirëpo për këtë çështje duhet ta kemi një konsultim publikë me grupet e interesit, për të qenë sa më racional, edhe në rastet kur do të kemi kërkesa për zgjatjen e orarit të punës, këto punë definojnë në nenin 15 dhe 16, ku duhet të rregullohet edhe rendi dhe qetësia publike, pastaj në nenet vijuese 18 dhe 21, parashihen edhe gjambat për shkelje eventuale që shqiptohen nga Drejtoria e Inspektoratit, ku gjambat për persona juridikë fillojnë nga 500.00€ deri në 2,000.00€, ndërsa për persona fizik deri në 300.00€. Në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ne pajtohemi që këto dy rregullore për të cilat fola unë dhe rregulloret tjera, që do të elaborohen nga kolegët e mi, të aprovohen në parim për procedurën e diskutimit publikë, ku jemi të hapur edhe si anëtarë të Grupeve Punues për shqyrtimin e kërkesave nga diskutimet publike, nëse ato nuk janë ndesh me legjislacionin në fuqi për fushën përkatëse.

Mirsad Qyqalla: Tani për ta evidentuar në ekstraktin e procesverbalit, ne kemi patur pjesëmarrje minimale në punën e disa grupeve punuese, për arsye se puna është realizuar në të njëjtën kohë në katër grupe të ndara, unë personalisht kam qenë më shumë prezentë në punën e Grupit Punues të 'Projekt-Rregullores për kushtet dhe kriteret për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë-Kosovës', në fushat që komuna jonë ndanë subvencione, ndërsa në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, e kemi theksuar se janë ndryshuar disa nene nga Administrata e Komunës, për të cilat ne jemi dakorduar si Grup Punues, unë kërkoi që ato nene të rikthehen, ose të na sqarohet në cilat pjesë bien ndesh me legjislacionin në fuqi, me këtë përmirësim ne jemi të pajtimit që kjo rregullore të aprovohet në parim për diskutim publik. Unë e dëgjova parafolësin tim, i cili u fokusua në diskutimin e tij në dy rregullore komunale dhe kërkoi që të përkrahen në parim edhe rregulloret tjera, për rregulloren e taksave komunale dhe orarit të punës për subjektet afariste, ne kemi punuar disa herë si grup, por kjo punë e kërkon një diskutim të hapur publikë me grupet e interesit, para miratimit përfundimtarë, sepse ka ndikim në buxhetin e komunës dhe zhvillimin e

biznesve në komunën tonë, por duhet të kemi parasysh edhe krijimin e rregullave të zbatueshme nga secili biznes në komunën tonë.

Hasan Ismajli: Unë i kam dhënë vërejtjet e mia në Grupin Punues për Rregulloren për kushtet kriteret për ndarjen e subvencioneve, aty kemi debatuar gjatë dhe kemi arritur në një dakordim për ndarjen e shumës së subvencioneve deri në dy mijë euro në shëndetësi për pacientët, kjo shumë nuk figuron tani fare në projektin të cilin e kemi në shqyrtim, nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, kemi raste kur ka patur financim deri në 8,800.00€, edhe te kultura janë disa fusha që meritojnë të përkrahen, ne duhet të jemi të kujdesshëm në vendosjen e këtyre kriterëve, sepse e dijmë se në të kaluarën janë financuar edhe libra në shuma të mëdha. Tek projekt-rregullorja e taksave komunale, kemi edhe uzurpime të hapësirave publike, ku shfrytëzohet edhe prona publike, aty njërëzitet kanë investuar me mijëra euro në bizneset e tyre, a ka mundësi që bizneset që i shfrytëzojnë këto hapësira publike, për një tavolinë të vendosur të paguajnë 0.50€ për një orë, pastaj ai i sheh kapacitetet e tij, a mund ta mban atë biznes, unë nuk jam që ato hapësira të rrënohen, por të vendoset një rregull në këtë fushë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ne tani jemi vetëm në leximin e parë të këtyre projekt-rregullore, do ta kemi edhe procedurën e diskutimeve publike, edhe konsultimeve të veçanta me grupet e interesit, po ashtu jemi të hapur për trajtimin e kërkesave të arsyeshme dhe që kanë mbështetje në ligje dhe udhëzime administrative për fushën e caktuar, andaj përmirësimet e mundshme mund t'i bëjmë deri në miratimin e tyre përfundimtarë.

Etnik Berjani: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë tani do të flas për 'Projekt-Rregulloren e Transportit Rrugor në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës', ku kanë qenë pjesëmarrës edhe znj. Jehona Gërguri dhe znj. Dardane Sogojeva Shala, që e njohin mirë fushën në fjalë, ne e kemi analizuar punën e qarkullimit me autobus, automjetet taksi të kompanive dhe personave fizik, në fund i kemi analizuar edhe gjobat për shkelje eventuale, kemi propozuar që ta kemi një zbritje të biletave për pensionistët deri në 30%, lirim të pjestarëve të Policisë së Kosovës dhe ushtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, kemi bërë një strukturim nëpër nene të caktuar për kompetencat dhe veprimet që duhet të mirren nga Drejtoria e Shërbimeve Publike e Mjedisit dhe Drejtoria e Inspektoratit. Kemi raste kur operatorët ekonomik funksionojnë edhe në Prishtinë, edhe tek ne, kërkesa është që ta keni ngjyrën e njëjtë të automjeteve, por marrë në tërësi ky është propozimi që e kemi ofruar ne, por ne jemi të hapur që ta kemi një diskutim publikë të hapur edhe me grupet e interesit. Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës propozojmë që 'Projekt-Rregulloren për Transportin Rrugor në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës', ta aprovojmë në parim për procedurën e diskutimit publik.

Krenar Dumani: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë kam qenë anëtar në dy Grupe Punues, por nuk kam mundur të marrë pjesë në punëtorin e organizuar në Prevallë për shtatë Grupe Punues, por ne në 'Rregulloren për orarin e punës' kemi punuar disa ditë në komunë më herët si Grup Punues. Kemi dhënë sugjerimet tona për shpërndarjen e subvencioneve në arsim, shëndetësi, Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, pastaj Zhvillim Ekonomik dhe Bujqësi, kemi kërkuar që të përkrahen fermerët, kemi kërkuar ta kemi një kod të veçantë për përkrahjen e fermerëve, ato janë në nenin 20, paragrafi 4, ku fermerët duhet të përkrahen me subvencione, kur dëmtohet puna e tyre nga vërshimet. Po ashtu me vendimin e Kuvendit të Komunës, e kemi bërë uljen e participimit në bujqësi nga 20%, në vetëm 3%, edhe unë i përkrah këto rregullore për aprovim në

parim për kalimin e tyre në procedurën e diskutimit publik, ku kërkojmë që ato të organizohen edhe me grupet përkatëse të interesit.

Fisnik Sllamniku: Unë nuk kam qenë pjesëmarrës vetë në hartimin e këtyre rregulloreve, por këto janë përgatitur nga njerëzit e fushës, duke patur parasysh ligjet dhe aktet nënligjore, unë tani do të ndalem tek 'Projekt-Rregullorja e Transparencës në Komunën e Fushë-Kosovës', ku parashihet transparenca e organeve komunale, duke përfshirë edhe ndërmarrjet publike, që pritet të krijohen në komunën tonë, sepse tani për tani në territorin e komunës tone, ne i marrim shërbimet nga kompanitë rajonale. Me këtë akt normativ ofrohet një qasje e hapur për publikun në nivelin komunal, ku kësaj transparence i nënshtrohet Kuvendi i Komunës, përmes dëgjimeve tjera për rritjen e transparencës për publikun e gjerë, nëpërmjet informimit nga komuna, përmes tubimeve publike për çështje të ndryshme publike, që janë në kompetencën e komunës, andaj ju ftoi që këtë projekt-rregullore, ta aprovojme në parim për diskutim publik.

Jetmir Berisha: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Tani unë në diskutimin tim, dua ta jap kontributin për sqarimin e punës tonë në kuadër të 'Projekt-Rregullores për bashkëpunimin e komunës me fshatra vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës', ku parashihet organizimi i këshillave lokale, pastaj zbërthehet vendimarrja e këtyre këshillave, si në zonat urbane, ashtu edhe në fshatrat tona. Zgjedhjet do të bëhen nga një Komision i themeluar nga Kuvendi i Komunës, në tubimet publike që mbahen në zonën e caktuar dhe kjo punë është e ndërlidhur me mandatin e Kuvendit të Komunës. Puna e këtyre këshillave, unë mendoj se do të jetë produktive, këtë fakt unë e mbështes edhe në bashkëpunimin, që ne e kemi në teren me përfaqësuesit e KFOR-it, kur kemi ndonjë çështje të caktuar, me zgjedhjen e këtyre udhëheqësve të fshatrave dhe lagjeve urbane me mandat katër vjeçar, rregullimin e procedurës së zgjedhjes dhe mënyrën e funksionimit me këtë rregullore, uroj që ne si Kuvend i Komunës ta rregullojmë edhe financimin e këtyre përfaqësuesve, që pritet të punojnë në teren për interesin e qytetarëve, sepse ata vijnë nga këto lokalitete dhe secili prej tyre e njëj mirë zonën e tij, i dijnë punët dhe aktivitetet që duhet të ndërmerren. Në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, propozoj që të aprovohet në parim për diskutim publik 'Projekt-Rregullorja për bashkëpunimin e komunës me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.

Jahush Krasniqi: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Unë kam qenë anëtar i Grupit Punues të Rregullores për Transparencë në Komunën e Fushë-Kosovës', ku parashihet transparenca e organeve komunale: Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës, ku më poshtë vijnë sipas hirarkisë edhe institucionet tjera të arsimit dhe shëndetësisë, kjo projekt-rregullore i ka 13 nene, ku zbërthehet e detajizuar qasja e hapur e publikut në mbikëqyrjen dhe monitorimin e punës së komunës, si institucion publikë, ku punohet në punën për planifikimin e buxhetit të komunës, planeve strategjike afatmesme, këtu në nenin 11 parashihet raportimi i komunës lidhur me kërkesat për qasje në dokumente zyrtare dhe arsytet për refuzimin e tyre. Unë tani këtu në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, propozoj që të aprovohet në parim për diskutimin publik 'Projekt-Rregullorja për Transparencë në Komunën e Fushë-Kosovës'.

Drejtori për Administratë: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Unë nuk kam qenë pjesë e punës në këto Grupe Punuese, por gjatë analizimit dhe shqyrtimit të 'Projekt-Rregullores për taksa komunale për subjektet afariste që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës', unë do të ndalem tek tabela e taksave komunale për ofrimin e shërbimeve të Zyra e Gjendjes Civile, ku mungojnë disa taksa komunale, të cilat ne kërkojmë që

të vendosen aty, ku hyn taksa që parashihen edhe me udhëzim administrativ për certifikata brenda dhe jashtë vendit, tek paragrafet 1.18, 1.19, ku jipet edhe deklarata e bashkësisë familjare, e cila është dy euro, certifikata e shtetësisë që është tri euro, andaj ne kërkojmë që këto taksa të përmirësohen, ne lidhur me këto lëshime, do të dorëzojmë me shkrim taksat komunale për shërbime administrative për Statusin e Gjendjes Civile.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim në parim për procedurën e diskutimit publik të 'Projekt-Rregullores për taksa komunale, për subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.

U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, e aprovoi në parim për procedurën e diskutimit publik të 'Projekt-Rregullores për taksa komunale, për subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për taksa komunale, për subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Projekt-Rregullorja për taksa komunale, për subjektet afariste që ushtrojnë veprimtari ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e rregullimit dhe ofrimit të taksave komunale vjetore për subjektet afariste që ushtrojnë veprimtari ekonomike në territorin e komunës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Rregullorja për taksa komunale, për subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Pika e katërt (4) - Propozim për shfuqizimin e vendimit Nr. 86, të datës 06.04.2023.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim 'Propozimin për shfuqizim vendimin me Nr. 86, të datës 06.04.2023, për aprovimin në parim për diskutim publikë të 'Projekt-Rregullores për orarin e punës së subjekteve afariste që ushtrojnë veprimtari ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.

U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, e aprovoi shfuqizimin e vendimit Nr. 86, të datës 06.04.2023, për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për orarin e punës së subjekteve afariste që ushtrojnë veprimtari ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës' dhe mori:

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit Nr. 86, të datës 06.04.2023, për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për orarin e punës së subjekteve afariste që ushtrojnë veprimtari ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Pika e pestë (5) - Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores për orarin e punës së subjekteve afariste që ushtrojnë veprimtari ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim në parim për procedurën e diskutimit publik të 'Projekt-Rregullores për orarin e punës, së subjekteve afariste që ushtrojnë veprimtari ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.

U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, e aprovoi në parim për procedurën e diskutimit publik të 'Projekt-Rregullores për orarin e punës, së subjekteve afariste që ushtrojnë veprimtari ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për orarin e punës, së subjekteve afariste që ushtrojnë veprimtari ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Projekt-Rregullorja për orarin e punës, për subjektet afariste që ushtrojnë veprimtari ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së subjekteve afariste që ushtrojnë veprimtari ekonomike në territorin e komunës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Rregullorja për orarin e punës, së subjekteve afariste që ushtrojnë veprimtari ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Pika e gjashtë (6) - Propozim për shfuqizimin e vendimit Nr. 87, të datës 06.04.2023.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për shfuqizim vendimin me Nr. 87, të datës 06.04.2023, për aprovimin në parim për diskutim publikë të 'Projekt-Rregullores për Transportin Rrugor në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.

U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, e aprovoi shfuqizimin e vendimit Nr. 87, të datës 06.04.2023, për aprovimin në parim për diskutim publikë të 'Projekt-Rregullores për Transportin Rrugor në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës' dhe mori:

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit Nr. 87, të datës 06.04.2023, për aprovimin në parim për diskutim publikë të 'Projekt-Rregullores për Transportin Rrugor në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.

Pika e shtatë (7) - Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores për transportin rrugor në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim në parim për procedurën e diskutimit publik të 'Projekt-Rregullores për transportin rrugor në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.

U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, e aprovoi në parim për procedurën e diskutimit publik të 'Projekt-Rregullores për transportin rrugor në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për transportin rrugor në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Projekt-Rregullorja për transportin rrugor në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e rregullimit dhe zhvillimit e sektorit të transportit rrugor në territorin e komunës së Fushë-Kosovës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Rregullorja për transportin rrugor në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Pika e tetë (8) - Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Pas sqarimeve tjera Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim në parim për procedurën e diskutimit publik të 'Projekt-Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës', sipas verzionit të hartuar nga Grupi Punues në tri nene të saj, duke bërë largimin e emërimit të diagnozave të sëmundjeve të ndryshme.

U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, e aprovoi në parim për procedurën e diskutimit publik të 'Projekt-Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës' sipas verzionin të hartuar nga Grupi Punues me kthimin e ndryshimeve në tri nene të saj, duke bërë largimin e emërimit të diagnozave të sëmundjeve të ndryshme dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Projekt-Rregullorja për kushtet kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e rregullimit dhe ofrimit të kushteve dhe procedurave për ndarjen e subvencioneve në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Rregullorja për kushtet kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Pika e nëntë (9) - Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores, për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim në parim për procedurën e diskutimit publik të 'Projekt-Rregullores, për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.

U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, e aprovoi në parim për procedurën e diskutimit publik të 'Projekt-Rregullores, për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores, për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Projekt-Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e rregullimit për organizim dhe bashkëpunim me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Fushë-Kosovës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Pika e dhjetë (10) - Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores për Transparencë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim në parim për procedurën e diskutimit publik të 'Projekt-Rregullores për Transparencë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.

U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, e aprovoi në parim për procedurën e diskutimit publik të 'Projekt-Rregullores për Transparencë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për Transparencë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Projekt-Rregullorja për Transparencë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e rregullimit dhe ofrimit e transparencës në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Rregullorja për Transparencë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Pika e njëmbëdhjetë (11) - Shqyrtimi i parë i Projekt-Planit të Veprimit për Transparencë për vitet 2024-2027 në Komunën e Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim në parim për procedurën e diskutimit publik të 'Projekt-Planit të Veprimit për Transparencë për vitet 2024-2027 në Komunën e Fushë-Kosovës'.

U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, e aprovoi në parim për procedurën e diskutimit publik të 'Projekt-Planit të Veprimit për Transparencë për vitet 2024-2027 në Komunën e Fushë-Kosovës' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Planit të Veprimit për Transparencë për vitet 2024-2027 në Komunën e Fushë-Kosovës

2. Plani i Veprimit për Transparencë për vitet 2024-2027 në Komunën e Fushë-Kosovës, i cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh zbatimin e transparencës nga institucionet komunale të Komunës së Fushë-Kosovës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Plani të Veprimit për Transparencë për vitet 2024-2027 në Komunën e Fushë-Kosovës.

Pika e dymbëdhjetë (12) - Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores, për Standardet minimale të pjesëmarrjes në diskutim publik në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim në parim për procedurën e diskutimit publik të 'Projekt-Rregullores, për Standardet minimale të pjesëmarrjes në diskutim publik në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.

U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, e aprovoi në parim për procedurën e diskutimit publik të 'Projekt-Rregullores, për Standardet minimale të pjesëmarrjes në diskutim publik në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin në parim për diskutim publik të Projekt-Rregullores, për Standardet minimale të pjesëmarrjes në diskutim publik në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Projekt-Rregullorja për Standardet minimale të pjesëmarrjes në diskutim publik në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e rregullimit dhe ofrimit të Standardet minimale të pjesëmarrjes në diskutim publik në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Rregullorja për Standardet minimale të pjesëmarrjes në diskutim publik në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Pika e trembëdhjetë (13) - Propozim për caktimin e taksës administrative për leje të ndërtimit, leje të rrënit dhe tarifës rregullative për rritjen e densitetit në Infrastrukturë në vitin 2024 në Komunën e Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani këtu e kemi një kalkulim që bëhet në bazë të rregullave që parashihen me udhëzimin administrative, në rastin konkret e kemi edhe pëlqimin për pranimin e këtyre taksave administrative për lëshimin e lejeve ndërtimore për vitin 2024, andaj e qesim në votim 'Propozimin për caktimin e taksës administrative për leje të ndërtimit, leje të rrënit dhe tarifës rregullative për rritjen e densitetit në Infrastrukturë në vitin 2024 në Komunën e Fushë-Kosovës'.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, e aprovoi në parim për procedurën e diskutimit publik të 'Propozimin për caktimin e taksës administrative për leje të ndërtimit, leje të rrënit dhe tarifës rregullative për rritjen e densitetit në Infrastrukturë në vitin 2024 në Komunën e Fushë-Kosovës' dhe mori:

V E N D I M

1. Për miratimin e Propozimit Nr. 371, të datës 30.10.2023, për caktimin e taksës administrative për leje të ndërtimit, leje të rrënimit dhe tarifës rregullative për rritjen e densitetit në Infrastrukturë në vitin 2024 si vijon:
 - 1.1 Taksa administrative për lëshimin e lejeve ndërtimore në shumë prej 1.50€ për një metër katror në kategorinë e parë;
 - 1.2 Taksa administrative për lëshimin e lejeve ndërtimore në shumë prej 1.65€ për një metër katror në kategorinë e dytë;
 - 1.3 Taksa administrative për leje të rrënimit në shumë prej 0.80€ për një metër katror;
 - 1.4 Tarifa rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturë në shumë prej 5.72€ për një metër katror.
2. Miratimi i taksave administrative dhe tarifës për rregullimin e densitetit në infrastrukturë për vitin 2024, mbështetet në shkresën e Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me Nr. 5761-2/23, të datës 17.10.2023.
3. Objektet publike institucionale që financohen nga institucionet shtetërore lirohen nga taksat për leje ndërtimore.
4. Llogaritja e taksave administrative për leje ndërtimore të kategorisë së parë dhe të kategorisë së dytë, leje të rrënimit dhe tarifa për rregullimin e densitetit në infrastrukturë, bëhet duke u mbështetur në pikën një të këtij vendimit.

Pika e katërmëdhjetë (14) - Propozim për formimin e Komisionit për zgjedhjen e krijuesit dhe sportistëve për vitin 2023

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi në shqyrtim 'Propozimin për formimin e Komisionit për përzgjedhjen e Krijuesit dhe sportistëve të vitit 2023', këtu kërkohet të formohen dy komisione, ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, që të na jap sqarime.

Drejtori për Kulturë Rini dhe Sport: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë tani e kam marrë këtë detyrë të re dhe në kuadër të autorizimeve të mia, ju kam propozuar juve që të merrni dy vendime për formimin e dy komisioneve, me nga shtatë anëtarë secili për përzgjedhjen e Krijuesit dhe Sportistëve të vitit 2023, kjo punë buron nga dispozitat e Rregullores së vitit 2016, për ndarjen e çmimeve mirënjohjeve dhe shpërblimeve tjera. Nga Ekzekutivi i Komunës për anëtarë të Komisionit për krijuesin e vitit 2023, i propozojmë znj. Elmije Grajçevci Zymberi, Ali Topalli dhe z. Ali Prebreza, ndërsa në Komisionin për përzgjedhjen e sportistëve të vitit 2023, i propozojmë z. Agron Breznica, z. Veton Dumani dhe z. Maliq Thaqi.

Laureat Gojnovci: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për anëtarë në komisionin për përzgjedhjen e Krijuesit të vitit 2023, e propozojmë z. Fisnik Sllamniku dhe znj. Arbnore Kelmendi, ndërsa në Komisionin për përzgjedhjen e sportistëve të vitit 2023, i propozojmë z. Jahush Krasniqi dhe znj. Qëndresa Ademi.

Mirsad Qyqalla: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, në komisionin për përzgjedhjen e Krijuesit të vitit 2023, e propozojmë znj. Dardane Sogojeva Shala, ndërsa në Komisionin për përzgjedhjen e sportistëve të vitit 2023, e propozojmë Mirsad Qyqalla.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë e propozoi tani vetën në komisionin për krijuesin e vitit 2023, ndërsa në komisionin për sportistët e vitit 2023 z. Hasan Ismajli.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Krijuesin e vitit 2023', në përbërje prej shtatë anëtarëve si vijon: Ali Ismaili, Fisnik Sllamniku, Arbnore Kelemendi, Dardane Sogojeva Shala, Elmije Grajçevci Zymberi, Ali Topalli dhe Ali Prebreza.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej gjashtëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, e aprovoi 'Propozimin për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Krijuesin e vitit 2023', në përbërje prej shtatë anëtarëve si vijon: Ali Ismaili, Fisnik Sllamniku, Arbnore Kelemendi, Dardane Sogojeva Shala, Elmije Grajçevci Zymberi, Ali Topalli dhe Ali Prebreza dhe mori:

V E N D I M

1. Për formimin e Komisionit vlerësues për zgjedhjen e 'Krijuesit të vitit 2023', në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve:
 - 1.1 Ali Ismaili - Kryesues i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.2 Fisnik Sllamniku - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.3 Arbnore Kelmendi - Anëtare e Kuvendit të Komunës, anëtare;
 - 1.4 Dardane Sogojeva Shala - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtare;
 - 1.5 Elmie Grajçevci Zymberi - Udhëheqëse e Sektorit për Arsim, anëtare;
 - 1.6 Ali Topalli - Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar;
 - 1.7 Ali Prebreza - Shoqëria Civile, anëtar.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit vlerësues, nga pika një e vendimit, është të shqyrtojë dhe vlerësojë kandidatët më të suksesshëm në konkursin për 'Krijuesin e vitit 2023'.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Sportistëve për vitin 2023', në përbërje prej shtatë anëtarëve si vijon: Jahush Krasniqi, Qëndresa Ademi, Mirsad Qyqalla, Hasan Ismajli, Agron Breznica, Veton Dumani dhe Maliq Thaqi.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej gjashtëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, e aprovoi 'Propozimin për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Sportistëve për vitin 2023', në përbërje prej shtatë anëtarëve si vijon: Jahush Krasniqi, Qëndresa Ademi, Mirsad Qyqalla, Hasan Ismajli, Agron Breznica, Veton Dumani dhe Maliq Thaqi dhe mori:

V E N D I M

1. Për formimin e Komisionit vlerësues për zgjedhjen e 'Sportistëve të vitit 2023', në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve:
 - 1.1 Jahush Krasniqi - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.2 Mirsad Qyqalla - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.3 Hasan Ismaili - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.4 Qëndresa Ademi - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtare;
 - 1.5 Agron Breznica - Zyrtar për Sport, anëtar;
 - 1.6 Veton Dumani - Zyrtar i Logjistikës, anëtar;
 - 1.7 Maliq Thaqi - Shoqëria Civile, anëtar.

2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit vlerësues, nga pika një e vendimit, është të shqyrtojë dhe vlerësojë kandidatët më të suksesshëm në konkursin për 'Sportistët e vitit 2023'.

Pika e pesëmbëdhjetë (15) - Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi pikën të ndryshme' ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që ta paraqesin ndonjë çështje nëse kanë për diskutim.

Hasan Ismajli: Unë kërkoi që ta kem një sqarim për kërkesën tim, pse në Statutin e Komunës së Fushë-Kosovës me Nr. 98, të datës 17.08.2012 në kuadër të Komitetit për Politikë dhe Financa parashihet të jenë nëntë anëtarë, këtu te ne penalizohen anëtarët e subjekteve tjera politike, unë nëse nuk e marrë ndonjë përgjigje, kërkesën time do ta dërgoi edhe në Gjykatën kompetente, për ta marrë një përgjigje, se kush është duke e shkelur Statutin e Komunës, që është akti më i lartë në nivelin komunal, që për komunën është sikur kushtetutë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 12:30 minuta.

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevci



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili

